



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Prill, 2025

01-30 prill, 2025

**PËRMBAJTJA E
BULETINIT**

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit prill 2024 dhe 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

**1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT PRILL
2025 DHE 2024**

Gjatë muajit prill 2025 janë raportuar **16,741 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(939.39 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (14,912 raste ose Inc 836.76 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Influenca sezonale (ILI) me 8,739 raste ose 490.37/100,000 banorë**, **Sindroma diareale me 4,000 raste ose 224.45/100,000 banorë**, dhe **ARI/ITPR me 3,301 raste ose 185.23 në 100,000 banorë (Tab.1)**.

Gjatë muajit prill 2025 janë raportuar 5 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 3 raste me dg. Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse dhe 2 raste me dg. Bronchopneumonia me diagnozë përcjellëse.

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, PRILL 2025

Gjatë muajit prill 2025 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me numrin më të lartë, (shih Tabela 1)

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit prill 2025 në IKShPK janë raportuar 8,739 raste me ILI (Inc. 490.37/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 1.08% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (8,835 raste) por krahasuar me muajin paraprak, mars 2025 me (12,517 raste të raportuara me ILI) vërehet ulje prej 30.18%, karakteristike kjo për sezonën dhe uljen e aktivitetit të qarkullimit të patogjenëve respirator.

Sindroma diareale: Gjatë muajit prill 2025 në IKShPK janë raportuar 4,000 raste me sindromë diareale (Inc.224.45/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,246 raste), vërehet një ulje prej 5.79% dhe gjithashtu krahasuar me muajin mars 2025, me 3,673 raste të raportuara, rritje prej 8.90%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

ARI/ITPR: Gjatë muajit prill 2025 në IKShPK janë raportuar 3,301 raste me ARI (Inc.185.23/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,104 raste) vërehet rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak mars 2025 me (1,876 raste).

Variçella: Gjatë muajit prill 2025 në IKShPK janë raportuar 398 raste me Variçellë (Inc.22.33/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (483 raste) vërehet ulje prej 17.59% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak mars 2025 me (371 raste), rritje prej 7.27%.

**Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë,
01 – 30 prill të vitit 2024 dhe 2025**

Tabela 1.

Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse dhe Incidenca/100.000 banorë në Kosovë, prill 2024-2025

<i>Sëmundjet/Shkaktarët</i>	prill, 2024		prill, 2025	
	Nr. i rasteve	Incidenca/100.000	Nr. i rasteve	Incidenca/100.000
COVID-19	5	0.28	3	0.17
ITPR - Pneumonia/ARI	1,104	61.95	3,301	185.23
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	11	0.62	8	0.45
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	8,835	495.76	8,739	490.37
Influenca A	6	0.34	3	0.17
Influenca B	18	1.01	2	0.11
RSV	11	0.62	12	0.67
Diarea akute	4,246	238.26	4,000	224.45
Variçela	483	27.10	398	22.33
Sindromi meningjeal	13	0.73	11	0.62
Kampilobakter		0.00		0.00
Helmimet me ushqim	33	1.85	71	3.98
Salmonella enteritidis	5	0.28		0.00
Gastroenterokolitet	24	1.35	118	6.62
Hepatiti akut A		0.00		0.00
Hepatiti akut B	5	0.28	3	0.17
Hepatiti akut C		0.00	1	0.06
Rubeolla		0.00	1	0.06
Morbilli		0.00		0.00
Parotiti epidemik	5	0.28	1	0.06
Pertussis	46	2.58	1	0.06
TBC		0.00	33	1.85
Tularemia	1	0.06		0.00
Brucelosis	2	0.11	2	0.11
Echinococcus	1	0.06	1	0.06
Sëmundja Lyme		0.00	1	0.06
Toxoplasmosis		0.00	1	0.06
HIV	2	0.11	1	0.06
IST	37	2.08	19	1.07
Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale me Rotavirus		0.00	3	0.17
Clostridium difficile	2	0.11		0.00
Giardiaza	3	0.17	4	0.22
*Sëmundjet tjera ngjitëse	14	0.79	3	0.17
Gjithsej	14912	836.76	16741	939.39

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Scarlatina, Herpes zoster, Erysipella, Mykozat, Mononucleoza

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:**Sëmundjet vaksinëpreventabile:**

Gjatë muajit prill 2025, nga gjithsej 3 raste të testuara si raste të dyshimta me Morbill nga laboratoritë e mikrobiologjisë në IKSHPKS-së, nuk është raportuar asnjë rast pozitiv.

Gjatë muajit prill 2025, nga laboratoritë e mikrobiologjisë në IKShPK-së janë raportuar: 1 rast pozitiv me Parotit, 1 rast me Pertussis dhe 1 rast me Rubellë. Rasti me parotit: komuna e Fushë Kosovës dhe i takon gjinisë mashkullore i vaksinuar një muaj më parë me vaksinën e MMR-së.

Rasti me Pertussis: komuna e Junikut dhe i takon grup-moshës mbi 18 vjeç, gjini mashkullore dhe status të rregullt vaksinal.

Rasti me Rubellë: komuna e Fushë Kosovës, gjini femërore, e vaksinuar një muaj më parë me vaksinën e MMR-së.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise:

Gjatë muajit prill nga ky grup i sëmundjeve nga laboratoritë e Mikrobiologjisë në IKShPK, janë raportuar 2 raste pozitive në Brucellozë dhe 1 rast pozitiv në Toxoplazmozë.

Sipas komunave rastet pozitive me Brucellozë (1 rast nga Podujeva dhe 1 rast nga Rahoveci), rasti me Toxoplazmozë është nga komuna e Lipjanit. Të gjitha rastet i përkasin gjinisë mashkullore. Sipas grup-moshës rastet i takojnë: 50-59 vjeç (1 rast), 40-49 vjeç (1 rast) dhe 30-39 vjeç (1 rast).

Nga këto raste, janë hospitalizuar në Klinikën Infektive 1 rast me Brucellozë nga Podujeva, derisa rastet tjera janë trajtuar në mënyrë ambulantore.

Nga anketimi epidemiologjik rezulton se: rastet janë sporadike pa ndonjë lidhshmëri me njëra tjetrën. Rastet me Brucellozë janë si pasojë e kontaktit direkt me kafshët.

Gjatë muajit prill është raportuar edhe 1 rast me borreliozë, nga komuna e Prishtinës, e gjinisë femërore dhe i takon grup-moshës 20-29 vjeç.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit prill, 2025 janë raportuar 11 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.61/100 000 banorë), prej tyre 6 raste me Meningjit akut viral, 4 raste me Meningoencephalitis akut purulenta dhe 1 rast me Meningjit tuberkular. Ky numër i rasteve të raportuara është përafërsisht i njëjtë krahasuar me periudhën e vitit 2024, ku ishin të raportuara gjithsej 13 raste (prej tyre 8 raste me Meningjit akut viral dhe 5 raste me Meningjit bakterial).

Sipas komunave, me nga 2 raste janë raportuar në komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Malishevës, me nga 1 rast komunat: Deçan, Klinë, Vushtrri, Mitrovicë dhe Vitia kurse Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Fushë Kosovës me 6/100,000 banorë.

Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultojnë se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 0-9 vjeç me 33.3% (4 raste), grup moshat 40-49 vjeç dhe 60-69 vjeç me 50% me nga (2 raste) kurse grup moshat 10-19 vjeç, 30-39 dhe 50-59 vjeç me nga 1 një rast të raportuar (16.6%).

Sipas gjinisë, rezultojnë se 64 % (7 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe të gjinia femërore me 36 % (4 raste).

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 2 shkaktarë në LCS, prej tyre: 1 rast me Epstein Barr Virus dhe 1 rast me HHV7.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit prill 2025 janë raportuar 118 raste me Gastroenterokolit dhe 71 raste me Helmim me ushqim. Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar: 2 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë 1 rast Prishtinë dhe 1 rast Ferizaj. Sipas grup moshave të dy rastet janë të grup moshës 0-4 vjeç, ndërkaq sipas gjinisë të 2 rastet janë të gjinisë femërore; 1 rast me Adenovirus nga komuna e Prishtinës, e gjinisë femërore dhe i takon grup moshës 0-9 vjeç; 1 rast me Echinococcus, nga komuna e Suharekës, e gjinisë femërore dhe i takon grup moshës 40-49 vjeç.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit prill 2025, në laboratorin e Mikrobiologjisë molekulare-IKShPK janë testuar 210 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator. Nga mostrat e testuara janë konfirmuar 5 raste me Influcencë A dhe B apo pozitivitet prej 2.38%. Sipas tipit: Influcencë A (3 raste apo 1.42%) dhe Influcencë B (2 raste apo 0.95%).

Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 12 (5.71%) mostra pozitive me RSV, 22 (10.47%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 19 (9.04%) mostra pozitive në Human Adenovirus, 17 (8.09%) mostra pozitive në Metapneumovirus dhe 4 (1.9%) mostra pozitive në Parainfluenca Virus.

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC, WHO për sezonën 2024/2025 si dhe Buletin javor për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike. Rastet pozitive në Influcencë A dhe B i përkasin komunave: Prishtinë (2 raste) dhe me nga një rast komunat : Gjilan, Lipjan dhe Mitrovicë. Rastet pozitive në virusin sincial (RSV) sipas komunave dhe grupmoshës : Prishtinë (7 raste), Fushë Kosovë (2 raste), Vushtrri (2 raste) dhe me një rast komuna e Skenderajit. Sipas grupmoshës, me Influcencë A dhe B : grupmosha 0-4 (2 raste) dhe me nga 1 rast grup-moshat : 15-34, 51-64 dhe 65+.

Prej 5 rasteve pozitive me Influcencë A dhe B, 2 prej tyre janë hospitalizuar në Klinikën Pediatrike, 1 në Klinikën Infektive dhe 1 në Klinikën e Pulmologjisë.

Gjatë muajit prill 2025, nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me Influcencë A dhe B.

Gjatë muajit prill 2025, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse, u raportuan gjithsej 8 raste me SARI. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenca dhe RSV. Prej tyre asnjëri nuk rezultoi pozitiv në viruset e lartëpërmendura.

Rastet SARI sipas komunave janë: Mitrovicë (2 raste) dhe me nga një rast komunat : Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Fushë Kosovë, Vushtrri dhe Podujevë. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (4 raste), 35-50 (3 raste) dhe 51-64 (1 rast). Sipas gjinisë, 5 prej tyre i takojnë gjinisë femërore dhe 3 gjinisë mashkullore.

Gjatë muajit prill 2025, janë shënuar 3 raste të vdekjes nga SARI (CFR=42.8).

Rastet e vdekjes i përkasin komunave si : Prishtinë (2 raste) dhe Ferizaj (1 rast) dhe i takojnë grup-moshës: mbi 65+ (2 raste) dhe 35-50 (1 rast).

Gjatë muajit prill 2025, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse nga janë raportuar 33 raste me TB (Inc.1.85/100,000 banorë) shih Tabela 1 dhe 2.

Rastet me HIV/AIDS/IST, prill 2025

Gjatë muajit prill 2025, është raportuar një rast me HIV. Rasti i takon gjinisë mashkullore, grup mosha 16-24 vjeç. Rruga e transmissiionit tek ky rast i raportuar, është homoseksuale (MSM).

Rasti është raportuar nga Departamenti i Mikrobiologjisë me MedLis (pacienti akoma nuk është lajmëruar në Klinikën Infektive, prandaj dhe mungon raportimi me SMSN).

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), prill 2025

Gjatë muajit prill 2025 janë raportuar gjithsej 19 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 7, Kaçanik 2, Pejë 2, Shtime 2, Prishtinë 1, Prizren 1, Gjakovë 1, Malishevë 1, Viti 1 dhe Shtërpçë 1. Sipas diagnozës: Chlamydia 16 raste, Condyloma 1, Sifilizi 1 dhe Gonorreja 1 rast. Sipas gjinisë: 16 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 3 raste gjinisë mashkullore. Grup moshës 25-49 vjeç i takojnë 14 raste dhe grup moshës 15-24 vjeç 5 raste.

Dy raste janë raportuar përmes SMSN, nga ana e QMF Orize (Gjakovë) dhe QMF Veternik (Prishtinë), 13 raste janë raportuar me anë të postës elektronike nga ana e një laborator privat në Ferizaj përmes QRShP Ferizaj, dy raste janë raportua me anë të postës elektronike nga ana e një laborator privat në Pejë përmes QRShP Pejë, një rast është raportuar me anë të postës elektronike nga ana e Repartit të Dermatologjisë, Spitali i Përgjithshëm - Prizren përmes QRShP Prizren dhe një rast me anë të formës raportuese me letër dhe është sjell në dorë nga ana e QKMF Prishtinë (QM6).

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C, prill, 2025

Gjatë muajit prill, 2025 janë raportuar 3 raste me Hepatit akut B (Mb. 0.22/100 000 banorë). Ky numër i rasteve të raportuara është përafërsisht i njëjtë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ku ishin të raportuara x raste me Hepatit akut B. Sipas komunave, janë raportuar me nga 1 rast: Prishtinë, Suharekë dhe Pejë. Sa i përket grup- moshës 70-79 vjeç (2 raste) dhe grup- mosha 20- 29 vjeç (1 rast). Sipas gjinisë rezulton se gjinia mashkullore (2 raste) kurse gjinia femërore me 1 rast.

Me Hepatit akut C, gjatë kësaj periudhe është raportuar një rast (1), 69 vjeç i gjinisë mashkullore nga Gjakova.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, prill 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, prill 2025																																		
SËMUNDJA	Pneumoni a/ARI	SARI	ILI	Diarrhea ac	Variçell a	Influen ca A	Influen ca B	RSV	COVID- 19	Sindroma meningjeale					Parotiti s epidemi ca	Pertuss is	Rubeolla	Hepatit ac. B	Hepatit ac. C	Helmin et me ushqim	Gastroe nteroka litet	Brucelo za	Infeksione t virale dhe infeksione t tjera specifike	Borelio za (Lyme Disease)	Toxopl azmoza	Echinoc ococ	IST	HIV	TB	Giardia za	Infeksion et streptoko ksike të gr. A	Sëm.tjer a ngjitëse	Totali	
KOMUNA										Meningj it serosa	Meningj it purulen t	Mening oencep halit ac.	Sepsis Mening ococcie a	Mening oencep halitis TBC																				
DEÇAN			34	31	2								1																				68	
DRAGASH	13		81	63	7															1	2												167	
DRENAS	305		57	59	11																								1				433	
F. KOSOVË	10	1	179	49	4			2		1	1			1		1					7								2				258	
FERIZAJ	11	1	331	175	18				1										1	10		1				7		6					562	
GJAKOVË	15		106	65	10												1	11	2							1				1			212	
GJILAN	13		417	172	32	1														1									4				640	
GRAÇANICË				0																														0
H. I ELEZIT	22		95	11	3																													131
ISTOG	3		82	24																3	1									2				115
JUNIK			23	10												1																		34
KAÇANIK	3		71	57	16																						2							149
KAMENICË	0		388	90	4																									1				483
KLINË	40		137	54	9							1								3										1				245
KLLOKOT				0																														0
LEPOSAVIQ				0																														0
LIPJAN				0	0	1														1	2				1					3				8
MALISHEVË	5		262	162	8						2									1	1						1							442
MAMUSHË			11	8	5																													24
MITROVICË		2	566	500	33	1						1									14													1117
MITROVICË E VERIUT																																		0
N. BËRDË	62		21	10	0																													93
OBILIQ	8		43	31	3															1										2				88
PARTESH																																		0
PEJË	4		545	209	11													1		3	2						2		2					781
PODUJEVË	21	1	450	169	20																2	1								1				665
PRISHTINË	2645	1	3262	1154	111		2	7	2	1	1						1		11	35		2	1			1	1	6						7244
PRIZREN	35	1	682	452	49															1	26										2			1249
RAHOVEC																						1												1
RANILLUG																																		0
SHTËRPCE																											1							1
SHTIME	18		189	27	9																						2			1				246
SKËNDERAJ	1		10	40	3			1													1													56
SUHAREKË	13		372	222	7													1			6					1					1			623
VITI	12		303	131	19						1																1							467
VUSHTRRI	42	1	22	25	4			2			1									34	4									1			1	137
Z. POTOK																																		0
ZVEÇAN																																		0
BURGUI LIPJANIT																					2													2
PA ADRESË																																		0
TOTALI	3301	8	8739	4000	398	3	2	12	3	6	4	0	0	1	1	1	1	3	1	71	118	2	3	1	1	1	19	1	33	4	0	3	16741	
*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza																																		
** Raste të importuara- Malaria, Mpox, Morbill																																		

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

** Raste të importuara- Malarie, Mpox, Morbill


3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT PRILL 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga rastet tjera të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit prill 2025

Tabela 3.

Sëmundja/shkaktari	Numri i rasteve
Pneumonia /ARI	119
SARI	8
Diarea akute dhe gastroenterocolite	156
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	2
Influenca A dhe B	4
Variçella	4
Hepatitis B	3
Sindroma meningjeale	11
Helmimet me ushqim	7
Brucellozë	1
Tularemi	1
Lyme Disease (Borelioza)	1
Mononucleosis	2
Erysipela	6
Exanthema	6
Status Febrilis	7
Vulnus Morsum Viperi	2
Totali	340



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT PRILL 2025

Epidemia familjare me Brucellozë në Rahovec

Rasti i parë i Epidemisë familjare komuna e Rahovecit, ka filluar më datë 25.03.2025 dhe është konfirmuar më datë 10.04.2025. Gjatë hulumtimit epidemiologjik bëhet e ditur se familja posedon rreth 30 krerë dele, ku prej tyre 2 krerë/dele janë asgjësuar nga inspektoriati veterinar i Agjencionit të Veterinës. Të ekspozuar ishin 5 anëtarë të familjes, pre tyre 2 rezultuan pozitiv në Brucellë dhe 1 rast i hospitalizuar ne Klinikën Infektive në Prishtinë.

Shenjat klinike: Plogështi, lodhje, temperaturë dhimbje koke dhimbje shpine etj.

Masat e ndërmarra: Vëzhgimi , hulumtimi i rasteve të reja , anketimi epidemiologjik , edukimi shëndetësor lidhur me sëmundjen shëndetësore.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre.

Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN

Institucioni shëndetësor	Numri i rasteve
AMF Breznicë	4
AMF Samadrexhë	1
AMF Sfeqel	2
AMF Strofc	1
AMF Xerxe	4
AMF-Qendra e studentëve	1
Klinika e Pediatriisë	1
Klinika e Pulmologjisë	7
Klinika e Sëmundjeve Ngjitëse- Infektive	84
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Ferizaj	5
QKMF - Fushë Kosovë	42
QKMF - Gjakovë	46
QKMF - Gjilan	8
QKMF - Glogoc	19
QKMF - Hani i Elezit	1
QKMF - Junik	10
QKMF - Kaçanik	4
QKMF - Klinë	9
QKMF - Lipjan	7
QKMF - Mitrovicë	3
QKMF - Obiliq	29
QKMF - Pejë	3
QKMF - Podujevë	69
QKMF - Prishtinë	13
QKMF - Prizren	16
QKMF - Skenderaj	28
QKMF - Vushtrri	1
QMF – 1	5
QMF Cermjan	1
QMF Ereniku	1
QMF Kërpimëh	1
QMF Lluzhan	20
QMF Lum i Madh	2
QMF Milloshevë	5
QMF Orize	34
QMF Ponosheci	18
QMF Qifllak	4
QMF Rahoveci	24


QMF Ratkoc	19
QMF Rogovë	6
QMF Skivjan	7
QMF Smrekonicë	8
QMF Veternik	1
QMF-1	23
QMF-2 Lakuriq	11
QMF-Besi	4
QMF-II	2
QMF-IV	29
QMF-IX	3
QMF-V	5
QMF-X	2
QMF-XI	14
Reparti i Pediatrie	1
Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë	49
Spitali i Përgjithshëm në Gjiilan	2
Spitali i Përgjithshëm në Pejë	4
Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri	51
TOTALI	774

Gjatë muajit prill 2025, përmes SMSN nga 59 institucione shëndetësore janë raportuar gjithsej 774 raste me sëmundje ngjitëse. Ky numër krahasuar me muajin mars 2025 me 766 raste të raportuara (36 institucione) shënon një rritje graduale të numrit të rasteve të raportuara përmes SMSN.

6. COVID-19

Gjatë muajit prill 2025, janë testuar 447 mostra të dyshimta në COVID-19 dhe prej tyre janë raportuar 3 raste pozitive me SARS-CoV-2 me një shkallë të pozitiviteti prej 0.67%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 (5 raste pozitive të raportuara), vërehet një rënie prej 40% në numrin e rasteve të raportuara. Gjatë muajit prill 2025 nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes nga COVID-19. (Grafikoni 1). Rastet pozitive, sipas komunave: 2 raste në komunën e Prishtinës dhe një rast në komunën e Ferizajt, kurse sipas grup-moshave: grup mosha 0-9 vjeç (2 raste) dhe grup mosha 50-59 (1 rast). Sipas gjinisë kemi 2 raste të gjinisë femërore dhe 1 rast të gjinisë mashkullore.

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, prill 2025



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, PRILL 2025

Përmbledhje e rasteve të fruthit të raportuara nga zyrat rajonale të OBSH-së

Rritja e aktivitetit të fruthit është raportuar globalisht. Janë regjistruar gjithsej 39 281 raste të fruthit të raportuar në Zyrat Rajonale të OBSH-së në vitin 2025. Që nga 10 prilli 2025, zyra rajonale e OBSH-së për Evropën (OBSH/EUROPE) raportoi 6 841 raste të fruthit në vitin 2025. Shumica e rasteve jashtë BE-së/ZEE u raportuan nga Kirgistani (2 970), Kazakistani (397) dhe Federata Ruse (373). Numrat e dhëna OBSH-së për vendet e BE/ZEE janë nga të dhënat e TESSy, të cilat janë përditësuar në baza mujore dhe të disponueshme në Atlasin e Mbikëqyrjes së Sëmundjeve ngjitëse të ECDC. Për shkak të dallimeve në kohët e raportimit, numrat mund të mos korrespondojnë me të dhënat nga kontrolli i inteligjencës epidemike. Zyra Rajonale e OBSH-së për Afrikën (OBSH AFRO) raportoi 10 623 raste të fruthit në vitin 2025, numri më i lartë i rasteve u raportua nga Etiopia (2 579), Nigeria (1 228), dhe Ruanda (817).

Më 5 prill 2025, Zyra Rajonale e OBSH-së për Amerikën (OBSH PAHO) raportoi 1 589 raste të konfirmuara të fruthit, duke përfshirë dy vdekje, nga pesë vende: Kanada (730), Shtetet e Bashkuara (712, duke përfshirë dy vdekje), Meksika (126), Argjentina (18) dhe Brazili (3). Kjo shënon një rritje të konsiderueshme nga 268 raste, përfshirë një vdekje të raportuar në shkurt 2025, për shkak të rritjes së numrit të rasteve në Kanada dhe SHBA.

Gjithashtu, mediat, duke cituar Ministrinë e Shëndetësisë, raportuan dy raste të fruthit në Belize. Të dyja rastet janë adoleshentë të pavaksinuar me histori udhëtimi në Meksikë.

Zyra Rajonale e OBSH-së për Azinë Juglindore (OBSH SEARO) raportoi 5 498 raste të fruthit. Numri më i madh i rasteve u raportua nga India (4 388), Indonezia (666), Tajlanda (336), Nepali (101) dhe Bangladeshi (5). Zyra Rajonale e OBSH-së për Mesdheun Lindor (OBSH EMRO) raportoi 12 897 fruth Numri më i madh i rasteve u raportuan nga Jemeni (4 569), Afganistani (4 182), Pakistani (2 799), Sudani (408) dhe Maroku (299). Zyra Rajonale e OBSH-së për Paqësorin Perëndimor (WHO WPRO) raportoi 2 185 raste të fruthit në 2025. Numri më i madh i rasteve u raportuan nga Filipinet (766), Kina (577), Kamboxhia (544), Vietnami (151) dhe Malajzia (104).

Vlerësimi i ECDC:

Numri i përgjithshëm i rasteve të fruthit në BE/ZEE u rrit në mënyrë të qëndrueshme midis qershorit 2023 dhe marsit të vitit 2024 para uljes ndërmjet prillit 2024 dhe shkurtit 2025. Rastet e fruthit mund të vazhdojnë të rriten në BE/ZEE në muajt e ardhshëm, në përputhje me sezonalitetin. Kjo është për shkak të raportimit të mbulimit jo optimal të vaksinimit për sëmundjen e fruthit vaksinat (MMR) në një numër vendesh të BE/ZEE, si dhe një probabiliteti të lartë të importimit nga zonat që përjetojnë qarkullim. Shumica e rasteve të raportuara së fundi e kanë marrë sëmundjen brenda vendit të raportuar përmes transmetimit në komunitet/lokal, megjithatë janë raportuar raste të lidhura me udhëtime ndërkombëtare.

Sezoni 2024/2025 i viruseve respiratore në Bashkimin Evropian

Zona Ekonomike (BE/EEA) është karakterizuar nga një sezon intenzive të gripit dhe një epidemi të virusit sincial respirator (RSV). Aktiviteti i SARS-CoV-2 ra në nivele të ulëta, deri më sot. Megjithatë aktiviteti i përgjithshëm i RSV arriti kulmin në BE/EEA në javën 52, 2024 dhe që atëherë është ulur, ai ka mbetur në numër të ngritur për shkak të ndryshimit të konsiderueshëm midis vendeve në kohën e sezonin e RSV. Aktiviteti i përgjithshëm i gripit arriti kulmin në javën e 6, 2025 dhe tani po vërehen tendenca në rënie për grip A(H1)pdm09, A(H3) dhe Viruset B/Vic. Shumica e vendeve përjetuan një sezon të hershëm të dominuar nga gripi A, i ndjekur nga A/B bashkëdominimi ose dominimi B. Për një numër të vogël

vendesh ka ndodhur e kundërta. Ndikimi më i madh në kujdesin sekondar është vërejtur tek të rriturit 45 vjeç e lart për gripi (me ndikimin që rritet me moshën) dhe tek fëmijët nën pesë vjeç për RSV. EuroMOMO raportoi vdekshmërinë nga të gjitha shkaqet mbi nivelet e pritura midis javës 51, 2024 dhe javës 9, 2025, duke prekur të rriturit 45 vjeç e lart, me nivele të vdekshmërisë tashmë të rikthyera në normale. Edhe pse niveli i aktivitetit të virusit është në rënie në shumë mjedise, vende me qarkullim të vazhdueshëm mund të pësojë presion mbi sistemet e kujdesit shëndetësor dhe kapacitetin spitalor.

Poliomieliti –Monitorimi mujor i shpërthimeve globale

Që nga 22 prilli 2025, janë raportuar tetë raste të paralizës akute të dobët (AFP) të shkaktuar nga poliovirusi i egër i tipit 1 (WPV1), gjashtë në Pakistan dhe dy në Afganistan. derisa nuk është raportuar asnjë rast i AFP-së për shkak të poliovirusit 1 (cVDPV1) ose 3 (cVDPV3) virus vaksinal .

Gjatë periudhës prill 2025, janë raportuar 38 raste të AFP për shkak të poliovirusit 2 (cVPDV2) me origjinë nga vaksina, nga gjashtë vende: Etiopia (16), Nigeria (11), Çadi (8), Angola (1), Xhibuti (1) dhe Nigeria (1).

Më 6 mars 2025, u mbajt takimi i 41-të i Komitetit të Emergjencës së Polio sipas Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit (RrNSh) (2005) për të diskutuar përhapjen ndërkombëtare të poliovirusit dhe u ra dakord që ai të mbetet një emergjencë e shëndetit publik me shqetësim ndërkombëtar (PHEIC). U lëshuan rekomandime të përkohshme për vendet e prekura, duke përfshirë vendet e BE/ZEE ku virusi u identifikua në mostrat mjedisore.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË**PUBLIKE TË KOSOVËS****Departamenti i Epidemiologjisë****Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000****WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>****E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net****Telefoni+38338 551432, ext. 1013**

